



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Doretuar Punimjen/Prodato Received/Delivered	06.07.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot.No	Shtojca Pilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHCK	5036/2023		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.767/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.767/2023 të datës 23/05/2023, të parashtruar nga ankuesja _____, nga fshati Livoç i Ulët, kundër organit të punësimit Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 në paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 05.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.757/2023 të datës 23.05.2023, të parashtruar nga ankuesja _____

A r s y e t i m

Ankuesja _____ Drejtore në Drejtorinë e Inspektionit në Komunën e Gjilanit, më datë 22.03.2023 për shkak të shkeljes së detyrave të punës ka iniciuar procedurën disiplinore ndaj nëpunësit Agim Kqiku i cili sipas akt emërimit të datës 14.02.2019 është i sistemuar në pozitën e punës "Udhëheqës i Sektorit për Pune Juridike dhe të Përgjithshëm" në Komunën e Gjilanit.

Komisioni Disiplinor në komunën e Gjilanit me datën 07.04.2023 ka mbajtur seancën dëgjimore, ndërsa me datën 15.05.2023 i njëjti ka marr vendimin me numër të protokollit 02-016-47631, me të cilin ankuesin e ka liruar nga përgjegjësia disiplinore pasi që të njëjtit kanë konstatuar se nuk ka ndonjë shkelje disiplinore.

Ankuesja _____ me datën 23.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër protokollit 02-016-47631 të datës 15.05.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjilanit, me pretendim se komisioni disiplinor në Komunën e Gjilanit ka marr vendim jo të duhur, pasi që zyrtari z. Kqiku ka injoruar

të gjitha email-et nga Drejtorja e Drejtorisë së Infeksionit dhe nuk ka dhënë asnjë informate lidhur me lëndët të cilat janë kërkuar, duke shkelur detyrat dhe përgjegjësit për të cilat është i cekur.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, më datë 30.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Gjilanit. Ndërsa më datë 31.05.2023 KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4379/2023 të datës 23.05.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Dokumentin e identifikimit të ankueses; Emalin e datës 01.06.2023 të drejtuar ; Emalin e datës 05.07.2022 të drejtuar ; Emalin e datës 21.09.2022 të drejtuar ; Emalin e datës 23.11.2022 të drejtuar ; Emalin e datës 06.01.2023 të drejtuar ; Formularin për kërkesë apo ankesë të datës 16.12.2022; Kërkesën me numër 14/580102-0142746122-95 të datës 16.12.2022; Vendimin me numër të protokollit 02-016-47631 të datës 15.05.2023 të Kryesuesit të Komisionit Disiplinore në Komunën e Gjilanit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.05.2023; Përgjigjenin me numër 92 të datës 14.02.2022 në ankesë të datës 31.05.2023; Vendimin për emërimin të Drejtorit të Drejtorisë; Emalin e datës 29.06.2023 të drejtuar KPMSHCK-së; Emalin e datës 26.06.2023 të I.Mehmti drejtuar F.Haliti; Kërkesën me numër 14/580103-002943123-23 të datës 22.03.2023; Akt emërimin me numër të protokollit 03/016-17038 të datës 14.02.2019; Procesverbalin e datës 07.04.2023 të Komisionit Disiplinore në Komunën e Gjilanit;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses , sepse:

Nga provat e lëndës është konstatuar së ankuesja me Vendimin me nr. prot. 94 të datës 14.02.2022 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit, është emëruar Drejtore e Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Gjilanit duke filluar nga data 14.02.2022.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 paragrafi 3 ku theksohet se: „3. Nëpunës civil është “.....zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë” dhe neni 2 paragrafi 5 i Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: „5. Nëpunës i Kabinetit - është zyrtari publik, që ushtron detyrën në Kabinetin e Presidentit, të Kryetarit të Kuvendit, të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, të Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit, të Ministrit ose të titullarit të një institucioni të pavarur kushtetues dhe të Kryetarit të Komunës. Statusin e nëpunësit të Kabinetit e kanë edhe nëpunësit të cilët ushtrojnë detyrat për nën kryetarin e Kuvendit të Kosovës dhe për grupin parlamentar” si dhe neni 76 paragrafi 1 dhe neni 77 paragrafi 1 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: “Marrëdhënia e punës e zyrtarit të kabinetit është

marrëdhënie besimi me titullarin e kabinetit të cilit i shërben zyrtari; 1. Nëpunësi i kabinetit përzgjidhet dhe emërohet në detyrë, lirisht, nga titullari i kabinetit” ,ndërsa sipas Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale respektivisht sipas nenit 65 të këtij ligji është përcaktuar së: Shërbimi civil komunal përfshin të gjithë personat e punësuar nga autoriteti komunal, rroga e të cilëve paguhet nga buxheti i Republikës së Kosovës, përveç: a) kryetarit, nënkryetarit/ve dhe drejtorëve komunal;, e mbi këtë bazë rrjedhë së pozita “ Drejtor Komunal” nuk hynë në kategorinë e nëpunësve civil, respektivisht ankuesja nuk e ka statusin e nëpunësit civil respektivisht pozita në të cilën është emëruar ankuesja hynë në kategorinë Nëpunës i Kabinetit.

Marrë parasysh konstatimin si me lartë dhe duke i'u referuar nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafit 1.1 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.767/2023 të datës 23.05.2023 gjegjësisht nuk është kompetent për të vendosur për ankesën të parashtruar nga ankuesja Entela Hyseni, sepse Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbim Civil ashtu siç përcaktohet me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku theksohet se: „ Këshilli shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësit civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin civil”.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesa bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë Konflikt Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar Vendimi. Inicimi i Konfliktit Administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.767/2023

Ilire MEHMETI-SHAQIRI


Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Gjilanit
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjilanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;